



## PROKURORIA E POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR

Tiranë, më 2.4.2025

**Lënda:** Parashtrime të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme në seancën gjyqësore të datës 2.4.2025, në çështjen ankim kundër vendimit nr. 762, datë 15.5.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit z. Afrim Shehu.

Të nderuar gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit!

Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, në ushtrimin e kompetencës së tij në procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, i qëndron të gjitha shkaqeve *për kriterin e kontollit pasuror* të parashtruara gjerësisht në ankimin me nr. 387/6 prot., datë 11.10.2024 të Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 762, datë 15.5.2024 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (*në vijim Komisioni*), për subjektin e rivlerësimit z. Afrim Shehu, sikurse detajuar në aktin “*Parashtrime...*” dërguar në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit me shkresën nr. \*\*\* prot, datë 17.3.2025, të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme.

Në mbështetje të nenit 4 pika 6 e ligjit nr.84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nenit 44 të ligjit nr.49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e mosmarrëveshjeve administrative” i ndryshuar, nenit 463 të Kodit të Procedurës Civile, *heqim dorë* nga shkaqet e ankimit që lidhen me *kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale*, konkretisht tri çështjet penale sipas shkaqeve dhe arsyetimit të parashtruar në mënyrë të detajuar në aktin “*Parashtrime .....*” dërguar në Kolegj me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 17.3.2025, të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme.

Në vijim në mënyrë të përbledhur parashtrojmë sa vijon:

**1 Për pasurinë “Apartment me sipërfaqe 72,20 m<sup>2</sup>”, në rrugën “ \*\*\* \*\*\* ” Tiranë, lidhur me burimet e deklaruara nga subjekti:**

**1.1 Lidhur me burimin e deklaruar: Të ardhura nga puna si avokat përgjatë periudhës \*\* .4.2002- \*\*.12.2003, dekluarar në shumën 2.518.333 lekë, vlerësojmë se përsa i përket të ardhurave të pretenduara në shumën 1.400.000 lekë, referuar akteve të depozitura mbi qarkullimin e dekluarar të biznesit pranë së cilit rezultonte i punësuar subjekti, (i) vlera e pretenduar si shpërblim në masën 20% të fitimit të aktivitetit, do të rezultonte**

ndjeshëm më e ulët se e ardhura e pretenduar prej 1.400.000 lekë si dhe (ii) nuk u provua mënyra e përfitimit të tyre nga subjekti si edhe pagesa e detyrimeve tatinore për to. Pretendimet e subjektit mbi përfitimin e të ardhurave nga zyra e noterisë së kunatës, me të njëjtat kushte kontraktuale si zyra e avokatisë e të vëllait, mbetën në nivel deklarativ dhe të pa provuara. Në mesin e burimeve të ligjshme të të ardhurave nga punësimi i subjektit si avokat për vitet 2002-2003, duhet të konsiderohet vetëm vlera e konfirmuar nga institucionet zyrtare, në shumën 956.340 lekë, e cila plotëson standardin e vendosur nga neni D pika 3 e aneksit të Kushtetutës.

**1.2** Lidhur me burimin e deklaruar: dhuratë nga vëllai, në shumën 10.041 euro<sup>1</sup>, nga hetimi ka rezultuar se shuma e pretenduar, nuk është transfertë nga i vëllai por e ka origjinën nga një depozitim në cash në llogarinë bankare të subjektit<sup>2</sup> dhe rezulton e tërhequr po në cash, në datë \*.2.2004, pra pas pagesës së këstit të parë datë \*\*.9.2003.

**1.3** Lidhur me huanë në shumën 4.000 usd, (pjesë e një huaje më të madhe 23.000 usd) marrë nga shtetasit \*\*\* \*\*\* 3, vlerësohet se është një burim i deklaruar gjatë hetimit administrativ në Komision dhe nuk reflektohet në asnjë prej deklaratave periodike vjetore apo vetting dhe nuk duhet të përfshihet në mesin e burimeve të ligjshme që kanë shërbyer për blerjen e kësaj pasurie. Deklarimet duket se janë bërë në funksion të përbysjes së pamjaftueshmërisë financiare të konstatuar dhe vlerësohen kontradiktore, pasi përveç se huaja 23.000 usd rezulton deklaruar si burim krijimi për një tjetër pasuri, në kontratën e huasë të vitit 2005 lidhur midis shtetasit \*\*\* \*\*\* dhe bashkëshortes së subjektit, nuk rezulton të përmendet shuma 4.000 usd, dhënë më parë apo mënyra e shlyerjes së saj dhe deklarimet mbi këtë hua nuk përputhen në vlerë dhe monedhë.

**1.4** Lidhur me pretendimet gjatë hetimit administrativ në Komision për të ardhura nga firmat piramidale (irreth 873.113 lekë) dhe emigracioni (2.000.000 lekë), vlerësohet se të ardhurat nga emigracioni, të padeklaruara në Deklaratën Vetting dhe në mungesë të akteve provuese, nuk plotësojnë kërkesat e parashikuara nga nenii D pika 3 e aneksit të Kushtetutës, ndërsa të ardhurat e pretenduara nga firmat piramidale, janë burime të deklaruara në një fazë të avancuar të hetimit administrativ dhe duket se janë bërë me qëllim përbysjen e diferencës negative të konstatuar.

**1.5** Lidhur me burimet e deklaruara për pagesat e kësteve në vijim<sup>4</sup> gjatë vitit 2005 referuar kohës së transferimit në llogarinë e subjektit dhe tërheqjeve në cash të shumave në vitin 2004, ato nuk mund të konsiderohen në mesin e burimeve të ligjshme të përdorura për shlyerjen e kësteve dhe mbulimin e shpenzimeve shtesë/mobilim gjatë vitit 2005 apo në vijim, për sa kohë që subjekti nuk ka deklaruar posedim të kursimeve në cash në deklaratën e parë të vitit 2004, referuar jurisprudencës së Kolegit, mbi trajtimin e kursimeve në cash<sup>5</sup>. Gjithashtu, vlerësojmë se analiza financiare duhet të kryhet për periudhën deri në momentet e pagesave (tetor 2005), analizë nga e cila

<sup>1</sup> Deklaruar në Deklaratën Vetting në shumën 10.041 euro, depozituar në datën \*.7.2003 pranë \*\*\*\* Bank,

<sup>2</sup> Në vlerën 19.000 euro më datë \*.7.2003.

<sup>3</sup> Kunati i subjektit, për të cilin deklarohet se si burim kanë shërbyer të ardhurat e shtetasit \*\*\* \*\*\*

<sup>4</sup> Këstít prej 10.000 usd në datë \*\*.9.2005; këstít të tretë 1.270.000 lekë në datë \*.10.2005 dhe pagesat cash për mobilimin në shumën 239.000 lekë.

<sup>5</sup> Në referencë dhe të arsyetimit mbi disponimin real të kursimeve, prgr. 25.35 i vendimit të arsyetuar.

konstatohet mungesë e burimeve financiare të ligjshme, përtej asaj të konstatuar nga Komisioni.

**1.6** Në përfundim për pasurinë "Apartament me sipërfaqe 72,20 m<sup>2</sup>" me adresë rruga " \*\*\* \*\* ", Tiranë, vlerësojmë se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë dhe të pamjaftueshmë lidhur me këtë pasuri, sipas përcaktimeve të nenit 33, pika 5, gjëma "b" e ligit nr. 84/2016 duke u ndodhur në kushtet e nenit 61 pika 3 ligit nr. 84/2016 dhe rezulton me pamjafueshmëri të burimeve të ligjshme për pagesën e këstít të parë, kësteve në vijim dhe mbulimin e shpenzimeve të mobilimit; subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarime kontradiktore dhe është përpjekur të paraqesë ndryshe burimet e ligjshme të krijimit të kësaj pasurie, duke ndryshuar deklarimet e tij.

**2 Për pasurinë "Apartament me sipërfaqe 103 m<sup>2</sup>", në rrugën " \*\*\* \*\* "  
Tiranë:**

**2.1** Lidhur me vlerën kësaj pasurie, vlerësojmë se referuar akteve në dosje, për këtë pasuri është paguar shuma prej 79.800 euro.

**2.2** Lidhur me mundësinë financiare të dhuruesit z. \*\*\* \*\* , edhe në konsideratë të përfshirjes në mesin e burimeve të ligjshme, të të ardhurave nga pensioni për periudhën 2003 - Mars 2008<sup>6</sup>, edhe pse një burim i deklaruar vetëm në përfundim të hetimit administrativ, nuk u provua tërësisht mundësia financiare e dhuruesit për të krijuar me burime të ligjshme shumën e deklaruar të dhruar prej 40.000 euro. Edhe deklarimet e subjektit, mbi dhurimin e një shumë prej 9.000 euro, transferuar në llogarinë bankare të tij nga shtetasi \*\*\* \*\* dhe pretenduar vetëm gjatë hetimit administrativ, si pjesë e shumës së dhruar nga babai i bashkëshortes, vlerësohen kontradiktore.

**2.3** Lidhur me huanë nga z. \*\*\* \*\* në shumën e deklaruar hua prej 23.000 usd, konfirmohet vetëm transferimi i shumës 15.296 euro në datë 5.10.2005<sup>7</sup> në llogari të subjektit. Deklarimet e subjektit dhe personit të lidhur me të, lidhur me këtë hua, sikundër trajtuar në pasurinë apartament me sipërfaqe 72,2 m<sup>2</sup> në rrugën " \*\*\* \*\* ", vlerësohen kontradiktore dhe jo në përputhje me aktet në dosje. Gjatë hetimit ka rezultuar se bashkëshortja e subjektit ka depozituar në cash në llogarinë e saj pranë \*\*\* \*\* Bank në datë \*\*.8.2005 shumën 22.600 usd, tërhequr po në cash në datat \*\*.9.2005 dhe \*\*.10.2005. Gjatë hetimit subjekti ka deklaruar se kjo depozitë është krijuar me kursime të z. \*\*\* \*\*, lënë në ruajtje nga ky i fundit, bashkëshortes së subjektit. Duket se subjekti i rivlerësimit, është përpjekur të justifikojë krijimin e pasurive të tij me të ardhurat e z. \*\*\* \*\*. Fakti se bashkëshortja e subjektit, në kohën c marrjes së huasë prej 23.000 usd nga shtetasi \*\*\* \*\* (hua c deklaruar me burim nga të ardhurat e z. \*\*\* \*\*), ka pasur në dispozicion në llogarinë bankare të saj, shumën prej 22.600 usd<sup>8</sup>, bëjnë të duket se shuma prej 22.600 usd ka si burim fonde të vetë subjektit të rivlerësimit.

<sup>6</sup> Të llogaritura në masën rreth 585.512 lekë (ose 4.778 euro).

<sup>7</sup> Sipas lëvizjeve të llogarisë së subjektit pranë \*\*\* \*\* Bank e cila konfirmon si urdhëruesh Z. \*\*\* \*\* .

<sup>8</sup> Deklaruar gjithashtu si kursime të shtetasit \*\*\* \*\* .

**2.4** Përsa i përket shlyerjes së mbetur të huasë së mësipërme, në vitin 2010, dekluarar me burim: pakësimin e një depozite pranë \*\*\* \*\*\* Bank, ka rezultuar se kjo depozitë, është krijuar nëpërmjet kreditimit të shumës 9.962 euro në maj 2009 me urdhëruar z. \*\*\* \*\*\* me përshkrim: "Dhënie huaje". Nisur nga fakti se nuk u provuan burimet e ligjshme të z. \*\*\* \*\*\* 9, vlerësohet se edhe shuma e tërhequr nga subjekti nga depozita në vitin 2010, përfektëtë këtij procesi, nuk mund të konsiderohet në mesin e burimeve të ligjshme përfshyerjen e huasë të marrë në vitin 2005.

**2.5** Në përfundim, përfshirinë "Apartment me sipërfaqe 103 m<sup>2</sup>", në rrugën " \*\*\* \*\*\* " Tiranë<sup>10</sup>, vlerësojmë se mbeten të paprovuara burimet e ligjshme të subjektit të rivlerësimit dhë personave lidhur e të tjera të lidhur me të<sup>11</sup>. Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë dhë të pamjaftueshëm lidhur me këtë pasuri, sipas përcakttimeve të nenit 33, pika 5, germa "b" e ligjit nr. 84/2016 duke u ndodhur përrnjedhoje, në kushtet e nenit 61 pika 3 ligjit nr. 84/2016.

**3. Përfshirinë "Garazh" me adresë rruga " \*\*\* \*\*\* ", Tiranë, vlerësojmë se, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarim të pasaktë dhë të pamjaftueshëm, sipas përcakttimeve të nenit 33, pika 5, germa "b" e ligjit nr. 84/2016 duke u ndodhur në kushtet e nenit 61 pika 3 ligjit nr. 84/2016<sup>12</sup>. Përsa trajtuar dhë më sipër në analizimin e pasurisë apartment me adresë " \*\*\* \*\*\* ", mbi pamjaftueshmërinë e burimeve të ligjshme përfshirin e pasurive të deklaruara në deklaratën e vitit 2009<sup>13</sup>, vlerësohet se subjekti i rivlerësimit nuk mbulon me burime të ligjshme pasuritë "garazh", krijuar në vitin 2009, në rrugën " \*\*\* \*\*\* ", në vlerën e plotë të blerjes së tyre, përtëj asaj të konstatuar nga Komisioni<sup>14</sup>.**

#### **4. Përfshirinë "Apartment me sipërfaqe 96,5 m<sup>2</sup>" në rrugën " \*\*\* \*\*\* " Tiranë:**

**4.1** Lidhur me mundësinë financiare të huadhënësit \*\*\* \*\*\*, përfshirë krijuar me burime të ligjshme shumat e dekluarar hua në vlerat 40.000 euro dhe 5.000 dollarë, vlerësojmë se kontrata e huasë është nënshkruar midis subjektit dhe shtetasit \*\*\*

\*\*\* dhe bazuar në nenin 32, pika 4 e ligjit nr.84/2016, subjekti i rivlerësimit dhë personat e tjera të lidhur me të, të deklaruar në cilësinë e huadhënësit, ( \*\*\* \*\*\* në këtë rast) kanë detyrimin përfshirë krijuar ligjshmërinë e burimit të krijuar të pasurive. Referuar akteve në dosje të ardhurat e ligjshme të huadhënësit, në shumat rreth 80.000 - 85.000 lekë/muaj, janë të pamjaftueshme përfshirë krijuar shumat e dhëna hua dhe përfshirë mbuluar njëkohësisht dhe shpenzimet e tij të jetesës.

<sup>9</sup>Pretenduar se edhe kjo shumë ka si burim të ardhurat e z. \*\*\* \*\*\* .

<sup>10</sup>Referohu trajtimin në faqen 10-13 të rekomandimit.

<sup>11</sup>Referuar dhe rekomandimit të ONM-së, pamjaftueshmëria financiare e akumuluar përfshi periodin 2006-2009 do të rezultonte në vlerën prej – 6.632.151 lekë, marrë në konsideratë përfshirin e burimeve të ligjshme të krijuar të pasurive vetëm shumën 15.296 euro, si dhe mundësia financiare të dhuruesit përfshirë dhuruar shumën deri në 36.280 euro.

<sup>12</sup>Referohu fq. 18 të rekomandimit të ONM-së.

<sup>13</sup>Referohuni detajimeve në mënyrë tabclarc në fq. 16-17 të Rekomandimit.

<sup>14</sup>Komisioni ka vlerësuar në analizën financiare përfundimtarë, pamundësi financiare të kryerjes së pagesës së blerjes së garazhëve, me të ardhura të ligjshme në shumë (-1.677.880 lekë ose rreth -12.232 euro).

**4.1.1** Gjatë hetimit administrativ, nuk u provua mënyra e dërgimit të këtyre të shumave nga z. \*\*\* tek z. \*\*\*<sup>15</sup> dhe/apo kthimi i tyre, duke mbetur të paprovuara pretendimet e subjektit se, burim për krijimin e këtyre shumave kanë qenë pikërisht të ardhurat e z. \*\*\*. Rethanat e mësipërme duhen vlerësuar në raport edhe me të dhënrat e Autoritetit të Inteligjencës Financiare, administruar në dosje të Komisionit.

**4.1.2** Për sa më sipër, *vlerësojmë se mbetën të paprovuara burimet e ligjshme të ardhurave të huadhënësit* \*\*\* si dhe pretendimet e subjektit se shumat e dhëna hua nga ky shtetas, kanë si burim të ardhurat e z. \*\*\* , duke mbetur në përfundim, të paprovuara: (i) burimet e ligjshme të pagesave të kryera gjatë vitit 2015<sup>16</sup>; (ii) burimet e ligjshme të huadhënësit \*\*\* , për huan në vlerë 40.000 euro që ka shërbyer për pagesën e këstir të dytë në vitin 2016, referuar kërkesave të nenit 32 pika 4 e ligjit nr. 84/2016; si dhe (iii) burimet e ligjshme të të ardhurave të deklaruara të përdorura për të mbuluar shpenzimet e mobilimit, nisur nga pamjaftueshmëria financiare e konstatuar për krijimin e kursimeve në cash prej 15.000 euro<sup>17</sup> si dhe kursimet e deklaruara në vitet në vijim.

**4.2** Lidhur me *të ardhurat nga shitja e pasurisë apartament* në rrugën “ \*\*\* ” Tiranë, nisur nga problematikat e konstatuara dhe pamjaftueshmëria e burimeve të ligjshme për blerjen e saj, (trajtuar më sipër) vlerësojmë se për qëllim të këtij procesi, të ardhurat e realizuara nga shitja e kësaj pasurie, nuk plotësojnë kushtet e parashikuara në nenin D të aneksit të Kushtetutës.

**4.3** Në përfundim për këtë pasuri, vlerësojmë se subjekti i rivlerësimit nuk provoi të kundërtën e barrës së provës dhe rezulton me mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e pasurisë apartament me sip. 96,5 m<sup>2</sup> në rrugën “ \*\*\* ” Tiranë, sipas përcaktimeve të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016 , duke u ndodhur për rrjedhojë, në kushtet e nenit 61 pika 3 ligjit nr. 84/2016.

**5. Përsa i përket zërave të tjerë të analizës financiare**, lidhur me *kursimet në cash, vlerësojmë se sikundër trajtuar në analizimin e pasurive të deklaruara Deklaratën e Parë para Fillimit të Detyrës 2009*, subjekti i rivlerësimit nuk provoi të kundërtën e barrës së provës dhe burimet e ligjshme që kanë shërbyer për mbulimin e shpenzimeve dhe investimeve të deklaruara, përfshi këtu dhe krijimin e kursimeve në *cash* në shumën 15.000 euro dhe si të tilla ato nuk mund të përfshihen në mesin e burimeve të ligjshme që kanë shërbyer për mbulimin e shpenzimeve dhe kursimeve në vitet në vijim, për rrjedhojë duke u ndodhur në kushtet e nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

**5.1** Lidhur me *shpenzimet e evidencuara nga karta e kreditit, vlerësojmë se* në këtë zë nuk duhet të përfshihen ato transaksione bankare që konfirmohen/identifikohen se janë

<sup>15</sup> Transfertat nëpërmjet illogarive bankare nga \*\*\* tek \*\*\* , identifikohen për një periudhë të mëvonshme se ajo e krijimit të shumës së dhëne nua.

<sup>16</sup> Referohu dhe trajtimi në fq. 21 dhe 24-25 të rekomandimit.

<sup>17</sup> Deklaruar në Deklaratën e Interesave Privatë Para Fillimit të Detyrës, dorëzuar në ILDKPKI datë \*\*12.2009.

kryer për persona të tretë, dhe/apo ato transaksione që identifikohen si të kryera për mbulimin e kostove të udhëtimit<sup>18</sup>, llogaritur në zërin përkatës.

6. Lidhur me analizën financiare ndër vite, vlerësojmë se, për sa trajtuar në mënyrë të detajuar në secilin shkak ankimi, në analizimin e pasurive të krijuara ndër vite, si për ato të deklaruara në deklaratën para fillimit të detyrës, ashtu dhe për pasuritë deklaruar në periudhën 2014-2016, pamjaftueshmëria financiare<sup>19</sup> rezulton përtëj asaj të konstatuar nga Komisioni. Nga ana tjetër, edhe vetë diferenca negative prej - 3.144.331 lekë, konstatuar nga Komisioni, tejkalon kufijtë e proporcionalitetit dhe standartit të vendosur në jurisprudencën e Kolegit. Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, sipas përcaktimeve të nenit 33, pika 5, germa "b" e ligjit nr. 84/2016 duke u ndodhur përrnjedhojë, në kushtet e nenit 61 pika 3 ligjit nr. 84/2016.

7. Sa më sipër bazuar në kërkesat e neneve Ç, D dhe F, të aneksit të Kushtetutës, nenin 4, pika 2, dhe nenin 61, pikën 3 të ligjit nr. 84/2016 Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, kërkon që shkaqet e këtij ankimi të merren në shqyrtim nga ana e Kolegit të Posaçëm të Apelimit dhe, në zbatim të nenit 66, pika 1, germa "b", të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të shqyrtimit të çështjes në seancë publike, të vendosë:

- *Ndryshimin e vendimit nr. 762, datë 15.5.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Afrim Shehu.*

## DREJTUESI I PROKURORISË SË POSAÇME

Altin DUMANI

<sup>18</sup> Referohu fq. 23 e vijim të Rekomandimit,

<sup>19</sup> Referohu tabelës fq. 24-25 të Rekomandimit.